

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

KURDETYROHET LARJA

- Të dalurit e spermës në gjumë apo duke qenë i zgjuar.

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sellem] thotë: "Duhet larë kur të dalë sperma". Kurse, Ummu Seleme [radijall-llahu anha] tregon se Ummu Saleme [radijall-llahu anha] ka thënë: "O i Dërguar i All-llahut, me të vërtetë All-llahu nuk turpërohet prej të vërtetës, a thua vallë gruaja duhet larë kur të ëndërron? Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: "Po, nëse sheh lagwshti (gjurmë)".

Kurse, sa i takon daljes së spermës kur është njeriu i zgjuar, atëherë duhet të jetë dalje me epush. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Kur të del ujë furishëm, laju nga xhunubllëku, e nëse nuk del furishëm nuk ka nevojë për larje".

Imam Shevkani thotë: "Dalja e spermës furishëm ndodh gjatë daljes së saj nga shkaku i epushit", dhe për këtë, shkruesi i librit ka thënë: "Se nëse sperma del për shkak të sëmundjes ose impotencës, nuk duhet larë. Po qe se ndokush ëndërron, e nuk heton gjurmë (ujë), nuk ka nevojë të lahet, por nëse gjen ujë e nuk i kujtohet ëndërimi, atëherë duhet larë. Aishja [radijall-llahu anha] thotë: "Është pyetur Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për njeriun i cili gjen lagështi në trupin e tij, e nuk i kujtohet ëndërimi, ç'të bën?", e Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i tha: "Le të lahet, e nëse ëndërron e nuk gjen lagështi, nuk ka nevojë të lahet".

- Kontakti seksual, edhe pse nuk ka ejakulim.

Ebu Hurejra [radijall-llahuanhu] thotë se

Muhammedi [sallall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: "Kur ndokush të ulet në mes të katër gjymtyrëve dhe kryen aktin seksual, është bërë larja e obliguar edhe pse nuk ka ejakulim".

Shtojcë: Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: "Kur të takohen dy synnetimet (dy organet gjenitale), obligohet larja". (domethënë, nëse futet koka e organit gjenital mashkullor brenda organit gjenital femror, kurse të gjithë dijetarët janë të mendimit se nëse vetëm e prekë e nuk hyn nuk ka nevojë të lahet).

- Kur kafiri pranon Islamin.

"Kajs Ibn Asimi pranoi Islamin, kurse Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e urdhëroi të lahet me ujë dhe sidër (bimë aromatike)".

- Ndërprerja e menstruacionit dhe lehonisë.

Aishja [radijall-llahu anha] thotë: Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i ka thënë bijës së Hubejshit: "Kur të vijë menstruacioni lëre namazin, e kur të dalësh nga ajo gjendje laju dhe falu". E sa i përket lehonisë, ajo është sikurse menstruacioni, e këtë duke u bazuar në ixhmanë e dijetarëve islamë.

KUSHTET E LARJES

Nijjeti duke u mbështetur në hadithin e të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]: "Çdo vepër vlerësohet sipas nijetit".

FORMA E LARJES

Aishja [radijall-llahu anha] thotë: "Pejgamberi [sallall-llahu alejhi ve sel-lem] kur lahej nga xhunubllëku, fillonte me larjen e duarve, e pastaj merrte ujë me dorën e djathtë dhe gjuante në të majtën, pastaj lante organin mëpastaj merrte abdest sikur për namaz, pastaj merrte ujë dhe gjuante në kokë duke futur gishtat në rrënjët e flokëve, e kur e shihte se ka fërkuar tërë kokën, gjuante tre grushta ujë në kokë, pastaj gjuante në tërë trupin e pastaj lante tërë trupin".

Vlen të theksohet: Kur gruaja të lahet nga xhunubllëku, nuk detyrohet t'i zgjidhë bystekët e

flokëve, kurse kur të lahet nga menstruacionet obligohet t'i zgjidhë. Ummu Seleme [radijall-llahu anha] thotë: "O i Dërguar i All-llahut, unë i bëj flokët bystekë, kurse kur të lahem nga xhunubllëku i zgjidhi". Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i tha: "Jo s'ka nevojë, të mjaftojnë tre grushta ujë e pastaj të lashë krejt trupin dhe kështu pastrohesh". Aishja [radijall-llahu anhu] thotë se Esmaja e ka pyetur Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për larjen pas menstruacioneve, e ai ka thënë: "Merr ujë dhe sidër, pastaj merr abdest mirë, pastaj gjuaj ujë në kokë dhe fërkoje mirë, derisa të arrijë deri tek rrënjët e flokëve e pastaj gjuaj sujë mbi to, pastaj merre një leckë të parfymosur dhe pastrohu me te".

Aishja [radijall-llahu anha] tha: "Sikur (ajo) të fshehë këtë, e ai [sal-lall-llahualejhi ve sel-lem] pastaj tha: "Pastroje me të gjakun ku ka dalë (gjurmët)". E unë (Aishja) e pyeta për xhunubllëkun, e ai më tha: "Merr ujë dhe merr mirë abdest, derisa të arrish mirë rrënjët e flokëve, pastaj gjuaj ujë tërë trupit". Ky hadith njëherit qartëson edhe dallimin mes larjes së gruas e cila lahet pas menstruacionit duhet që të fërkohet më tepër sesa ajo që lahet nga xhunubllëku, e gjithashtu duhet që t'i zgjidhë bystekët. Në esencë, duhet zgjidhur bystekët për të arritur uji në rrënjët e flokëve, mirëpo Sheriati ia ka lehtësuar grave, ngase larja nga xhunubllëku ndodhë më shpesh, e me këtë shkakton vështirësi, gjë e cila nuk ndodhë me rastin e menstruacionit, e cila ndodhë një herë në muaj.

Shënim: Lejohet që burrë e grua të lahen së bashku në një vend dhe të shikojnë avretin e njëri tjetrit, e këtë duke u bazuar në thënien e Aishes [radijall-llahu anha]: "Lahesha me Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi vesel-lem] prej një ene duke qenë xhunubë (që të dytë)".

KUR ËSHTË MUSTEHAB LARJA

- Larja pas çdo akti seksual.

Ebu Rafiu transmeton se një natë Pejgamberi [sal-

lall-llahu alejhi ve sel-lem] i vizitoi të gjitha gratë e tij dhe u lante pas çdo akti. I thashë: "O i dërguar i All-llahut, përse nuk lahesh në fund njëherë?", ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: "*Kështu është më mirë dhe më pastër*".

- Larja e gruas që është në istihada për çdo namaz, ose larja për Drekë dhe lkindi së bashku me Akshamin dhe Jacinë së bashku dhe për çdo mëngjes veçmas.

Aishja [radijall-llahu anha] thotë: "Ummu Habibën e takoi istihadanë kohën e Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e ai e urdhëroi që të lahet për çdo namaz".

- Larja pas alivanosjes.

Aishja [radijall-llahu anha] thotë: "Kur u sëmur Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] pyeti: '*A janë falur njerëzit?*'. I thamë: "Jo, po të presin ty, o i Dwrguar i All-llahut", e ai [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: "*Mbusheni kovën me ujë*".

Aishja [radijall-llahu anha] tha: "Ia mbushëm kovën me ujë, e ai [sal-lall-llahualejhi ve sel-lem] u la dhe shkoi për t'u falur, mirëpo prap u alivanos, kur erdhi në vete tha: "*A janë falur njerëzit?*". I thanë: "Jo, po të presin ty, o i Dwrguar i All-llahut". E Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: "*Ma mbushni një kovë me ujë*". E ne ia mbushëm, u la Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe shkoi që të falet, por, sërish u alivanos, e kur erdhi në vete tha: "*A janë falur njerëzit?*". I thanë: "Jo, po të presin ty, o i Dwrguar i All-llahut, e pastaj turdhwroi që Ebu Bekri të dalë imam".

- Pastrimi pas varrimit të mushrikut.

Aliu [radijall-llahu anhu] thotë: "Shkova te Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe i thashë: "Ebu Talibi ka vdekur, e ai më tha: "*Shko dhe varrose*", e kur u ktheva nga varrimi i tij, me tha: "*Shko laju!*".

- Larja për dy Bajramet dhe Ditën e Arafatit.

Transmeton Shafiu [radijall-llahu anhu] nga Zadhani i cili thotë: "Një njeri e pyeti Aliun [radijall-llahu

anhu] për larjen e ai i tha: "Laju për çdo ditë nëse ke mundësi", e ai i tha: "Jo, po të pyes për larjen që është larje?", e Aliu [radijall-llahu anhu] i tha: "Ditën e Xhumasë, ditën e Arafatit, ditën e Bajramit të Kurbanit dhe Fitër Bajramit".

- Pastrimi për atë që e lanë të vdekurin.

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhive sel-lem] thotë: "*Kush të lajë xhenazen, le të lahet*".

- Larja para veshjes së ihramit për Haxhë ose Umre.

Zejd Ibn Thabiti [radijall-llahu anhu] thotë: "E kam parë Pejgamberin [sal-lall-llahualejhi ve sel-lem] kurr i nxorri lë gjitha teshat për të veshur ihramin dhe u la".

- Larja për të hyrë në Mekke.

Abdull-llah Ibn Umeri [radijall-llahu anhu] asnjëherë nuk ka hyrë në Mekke, e të mos jetë ndalë në Dhu-Tava, derisa e takonte mëngjesi, lahej pastaj hynte në Mekke dhe thonte: "Kështu ka vepruar Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]".

- Të larët në Ditën e Arafatit.

E këtë duke u bazuar në hadithin e Aliut [radijall-llahu anhu] të sipërpërmendur.

Shkëputur nga kaptina e pastërtisë:
El-Vexhiiz min fikhis-Suneh el-Kitabil Aziz
Autor: AbdulAdhim el-Bedevis

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
e-mail: penastudentore@hotmail.com

